



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr. 04, datë 22.01.2021

PËR DHËNIEN E TITULLIT “QYTETAR NDERI” I SKRAPARIT

Z. SPARTAK BRAHO

Këshilli Bashkiak Skrapar, në mbledhjen e datës 22.01.2021, mori në shqyrtim kërkesën e Komitetit të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare dhe Shoqatës Atdhetare “TOMORRI”, ardhur në Këshillin Bashkiak me propozimi të Kryetarit të Bashkisë, Z. Adriatik Mema, mbështetur në Ligjin Nr.139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Ligjin Nr. 112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, neni 14, 15 pika 1, gërma “a”, pika 2, gërma “b”, neni 16 dhe vijues,

VENDOSI:

1. Dhënie e titullit “Qytetar Nderi” i Skraparit, Z. Spartak Braho, me motivacionin:  
*“Në vlerësim të veprimtarisë së tij të shquar si deputet i Kuvendit të Shqipërisë në disa legjislatura, si publicist dhe veprimtar i devotshëm shoqëror në mbrojtje të vlerave historike të Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare dhe të rënëve në këtë luftë, promovimit të vazhdueshëm përmes lartësimit të figurave të shquara të Skraparit”.*
  2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Skrapar.
  3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
- Vendimi u miratua me 14 vota pro, vota kundër – s’ka, vota abstenim – s’ka.

Për konfirmim Prefektit të Qarkut.



KRYETARË KËSHILLIT BASHKIAK

Edlira SHKËMBI

